



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 639 Akti

Nr. 739 Vendimi
Tiranë, më 26.2.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 26.2.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Mimoza Margjeka**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe Aneksi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor të relatorit të çështjes, komisionerin Roland Ilia, mbështetur mbi dokumentin *Gjetje dhe Mendim* të vëzhguesit ndërkombëtar, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka,

V Ë R E N:

1. Subjekti i rivlerësimit Mimoza Margjeka, në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, ushtronte detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe pranë Gjykatës së Apelit Korçë sipas një skeme delegimi. Në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Mimoza Margjeka është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2005 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” ka hedhur shortin në muajin dhjetor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët: Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Roland Ilia, ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua komisionerja Genta Tafa (Bungo). Anëtarët e trupit gjykues kanë deklaruar mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
4. Sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve e rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, është vendosur fillimi i hetimit administrativ, nga ku janë administruar edhe raportet përkatëse nga institucionet ligjzbatuese.
5. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
6. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Faktet dhe rrethanat lidhur me çështjen

7. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka protokolluar shkresën me lëndë *Gjetje dhe Mendim* të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), me nr. *** prot., datë 16.3.2023, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 16.3.2023.

8. ONM-ja për dokumentin *Gjetje dhe Mendim* është bazuar në shkronjën “b” të pikës 3 të nenit B të Aneksit “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në nenin 49, pikat 10 dhe 11 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

- Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksi “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, neni B, pika 3, shkronja “b”: “*Vëzhguesi ndërkombëtar... paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelit ...*”.
- Sipas nenit 49, pika 10 e ligjit të rivlerësimit kalimtar: “*Gjetja, e paraqitur në formën e një deklarate, dokumenti ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji i Apelit e çmon gjetjen si të barasvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit...*”.
- Sipas nenit 49 të paragrafit 11 të ligjit të rivlerësimit kalimtar: “*Një mendim me shkrim i dhënë nga vëzhguesit ndërkombëtarë konsiderohet një përfundim i dhënë për një rrethanë konkrete gjatë procesit të rivlerësimit ose që rezulton nga faktet në çështje të veçanta [...]*”.

8.1 Duke u bazuar në sa më sipër dhe sipas kërkesave të pikës 4 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, është paraqitur një *Gjetje*, ku parashtrohet:

- Në lidhje me ekzistencën e një dënimi në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 319/ç e 25 të Kodit Penal, shpallur me vendimin e datës 15.12.2022 të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
- Gjykata e sipërcituar ka dënuar subjektin e rivlerësimit me 4 vjet dhe 6 muaj burgim dhe ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit në përputhje me nenin 59 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Subjekti i rivlerësimit është vendosur në shërbim prove për një periudhë 3-vjeçare. Dhe e fundit, por jo për nga rëndësia, në bazë të nenit 35 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, subjektit të rivlerësimit i është hequr e drejta për të ushtruar funksione publike për 5 vjet.
- Vëzhguesi ndërkombëtar paraqet gjithashtu si *Gjetje* ekzistencën e një standardi ligjor, siç theksohet në vendimin nr. 28/2019 të Kolegjit për subjektin e rivlerësimit E. M., sipas të cilit sjellja e subjektit të rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

9. Bazuar në sa më sipër, është paraqitur *Mendim*, në mënyrë që Komisioni të administrojë vendimin e sipërpërmendur si provë dhe ta konsiderojë në vlerësimin e përgjithshëm të procesit të rivlerësimit.

Përmbajtja e Mendimit

9.1 ONM-ja ka administruar nëpërmjet shkresës së datës 28.12.2022 (nr. *** prot.) një përgjigje nga Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që përmbante një kopje të vendimit të shkurtuar nr. ***, datë 15.12.2022. Ky vendim lidhet me dënimin e subjektit të rivlerësimit për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe

funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 319/ç e 25 të Kodit Penal.

9.2 Gjykata e ka dënuar subjektin e rivlerësimit me 4 vjet dhe 6 muaj burgim dhe ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit në përputhje me nenin 59 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Subjekti i rivlerësimit është vendosur në provë për një periudhë 3-vjeçare. Në bazë të nenit 35 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, subjektit të rivlerësimit i është hequr e drejta për të ushtruar funksione publike për 5 vjet.

9.3 Vëzhguesi ndërkombëtar paraqet si *Gjetje* përmbajtjen e vendimit të mësipërm, kopja e plotë e të cilit është administruar nga ONM-ja më 9.3.2023.

9.4 Vëzhguesi ndërkombëtar ka paraqitur si gjetje shtesë parimet e shprehura në vendimin nr. 28/2019 të Kolegjit për subjektin e rivlerësimit E. M. si vijon:

- Më konkretisht, Kodi i Etikës së gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, në rregullin 15 përcakton: *“Gjyqtari duhet të kryejë të gjitha veprimtaritë jashtëgjyqësore në mënyrë të tillë që ato të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tij, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore”*.

9.5 Në komentarin e Parimeve të Bangalorës për sjelljen gjyqësore është trajtuar gjerësisht sjellja e gjyqtarëve në veprimtarinë jashtëgjyqësore duke e lidhur me elemente të dinjitetit, integritetit, paanësisë dhe reputacionit, ndër të tjera. Për sa i përket sjelljes së gjyqtarëve, në komentar, ndër të tjera, shtjellohet:

- Paragrafi 108 – Kërkohet respektimi i rreptë i ligjit – *Shkelja e ligjit nga një gjyqtar mund të dëmtojë reputacionin e funksionit si gjyqtar, të inkurajojë mosrespektimin e ligjit dhe të cenojë besimin e publikut në integritetin e vetë gjyqësorit... Një gjyqtar është i detyruar të mbështesë ligjin. Ai ose ajo nuk duhet të vendoset në një pozicion konflikti në zbatim të ligjit. Çfarë të tjerët mund të shihet si një shkelje relativisht e vogël, te gjyqtari mund të tërheqë publicitet dhe dëmtojë imazhin e gjyqtarit dhe të shtrojë pikëpyetje në lidhje me integritetin e tij/saj dhe integritetin e gjyqësorit.*

- Paragrafi 109 – Sjellja personale e një gjykatësi ndikon në të gjithë sistemin gjyqësor – *Besimi në gjyqësor bazohet jo vetëm në kompetencën dhe zellin e anëtarëve të tij, por edhe mbi integritetin dhe drejtësinë e tyre morale. Gjykatësi jo vetëm që duhet të jetë një “gjyqtar i mirë”, por edhe një “person i mirë”, edhe nëse pikëpamjet për çfarë nënkupton ky koncept mund të ndryshojnë në qarqe të ndryshme të shoqërisë. Nga këndvështrimi i publikut, një gjykatës jo vetëm që është zotuar t’u shërbejë idealeve të drejtësisë dhe të vërtetës mbi të cilat është ndërtuar shteti ligjor dhe themelet e demokracisë, por edhe t’i mishërojë ato. Në përputhje me rrethanat, cilësitë personale, sjellja dhe imazhi që projekton gjyqtari ndikojnë në sistemin gjyqësor në tërësi dhe, rrjedhimisht, edhe vetëbesimin që publiku vendos në të. Kërkesat e publikut ndaj gjyqtarëve janë shumë më të larta sesa kërkohet nga bashkëqytetarët, standarde të sjelljes që janë shumë më të larta se ato të kërkuara të shoqërisë në tërësi. Në fakt, publiku pret një sjellje pothuajse të paqortueshme nga një gjykatës. Është sikur funksioni gjyqësor, që është gjykimi i të tjerëve, ka imponuar një kërkesë që gjyqtari të mbetet përtej gjykimit të arsyeshëm të të tjerëve në çështje që mund të cenojnë në çfarëdolloj mënyre rolin gjyqësor dhe gjykatën.*

- Paragrafi 111 – Si mund të duket kjo në sytë e publikut – ... *Ajo që ka më shumë rëndësi nuk është çfarë bën apo nuk bën një gjyqtar, por atë që të tjerët mendojnë se ka bërë gjyqtari ose mund të bëjë...*

9.6 Në opinionin nr. 3 të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë [Consultative Council of European Judges (CCJE)] mbi parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në veçanti etikën, sjelljen e papajtueshme dhe paanshmërinë (Strasburg, datë 19.11.2002), shkruhet: “... Në jetën shoqërore gjyqtari duhet të sillet me dinjitet dhe korrektësi dhe të mbetet i vëmendshëm ndaj interesit publik. Brenda kuadrit të funksioneve të tij dhe në çdo akt profesional, ai duhet të frymëzohet nga vlerat që janë përtej interesimit personal, të pavarësisë dhe paanshmërisë...”.

9.7 Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vëren se sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me mënyrën e sjelljes që pritet nga një gjyqtar, i cili edhe jashtë orarit të punës duhet të kujdeset që sjellja e tij të jetë në të mirë të funksionit zyrtar që ushtron, të mos karakterizohet nga fiktiviteti dhe mashtrimi i çdolloji...

9.8 Vëzhguesi ndërkombëtar mendon se sjellja e subjektit të rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë dhe se përmbajtja e vendimit të gjykatës bashkëngjitur këtij dokumenti duhet të konsiderohet nga Komisioni në vlerësimin e përgjithshëm të procesit të rivlerësimit.

Vlerësimi i Komisionit

10. Sa më sipër, trupi gjykues i shortuar për rivlerësimin kalimtar të subjektit Mimoza Margjeka, duke konsideruar këtë dokument *Gjetje dhe Mendim*, të ONM-së, është mbledhur në datën 27.3.2023, me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, i cili kërkoi marrjen parasysh të këtyre informacioneve të shprehura në shkresën *Gjetje dhe Mendim*, nr. *** prot., datë 16.3.2023.

11. Trupi gjykues mori në konsideratë dhe bëri pjesë të rezultateve të hetimit gjetjet dhe mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar, duke i çmuar të domosdoshme për procesin e rivlerësimit të subjektit Mimoza Margjeka, pasi subjekti i rivlerësimit është dënuar nga Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

12. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), pas hetimit të kryer, ka akuzuar të pandehurën Mimoza Margjeka për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 319/ç-25 të Kodit Penal. Në vijim, SPAK-u ka kërkuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar deklarimin fajtor të së pandehurës Mimoza Margjeka dhe dënimin e saj me 4 vite e 6 muaj burgim.

13. Në përfundim të gjykimit, gjykata e ka dënuar subjektin e rivlerësimit me 4 vjet dhe 6 muaj burgim dhe ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit në përputhje me nenin 59 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Subjekti i rivlerësimit është vendosur në provë për një periudhë 3-vjeçare. Në bazë të nenit 35 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, subjektit të rivlerësimit i është hequr e drejta për të ushtruar funksione publike për 5 vjet.

14. Në vendimin e saj gjykata ka konstatuar se:

- Në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurve A.C. dhe Mimoza Margjeka për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 319/ç - 25 të Kodit Penal, Prokuroria, në kërkesën për gjykim si dhe në pretendimet gjatë gjykimit, deklaroi se të pandehurit me veprimet tyre kanë konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga nenet 319/ç - 25 të Kodit Penal, pasi nga rrethanat e faktit rezulton se ata i kanë konsumuar të gjitha elementet objektive e subjektive të marra së bashku, që kjo vepër penale të konsiderohet e kryer.

- Këtë vepër penale të pandehurit e kanë kryer në bashkëpunim me njëri-tjetrin ku e pandehura Mimoza Margjeka ka ushtruar funksionin e gjyqtares, ndërsa i pandehuri tjetër A.C. edhe pse nuk është subjekt i posaçëm ka marrë pjesë në këtë marrëveshje korrupsioni në cilësinë e bashkëshortit të së pandehurës Mimoza Margjeka dhe ka qëndruar në anën e saj. I pandehuri A. C. konstatohet se ndodhet në rolin klasik të bashkëpunëtorit të së pandehurës Mimoza Margjeka. Ka qenë ai i pari që ka marrë kontakt me palën tjetër, përfaqësuar nga i pandehuri K. Zh., e më pas edhe me të pandehurin S. D. ka qenë ai që ka siguruar takimin mes të pandehurve Mimoza Margjeka dhe K. Zh. në mëngjes, ditën e gjykimit të ankimit të vendimit për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin O. B. dhe ka qenë ai që ka kontribuar në realizimin e plotë të korrupsionit nëpërmjet takimeve, komunikimeve dhe bisedave të transportuara përgjatë datës 29.7.2020 nga njëra palë tek tjetra. Rezulton e provuar se marrëveshja e korrupsionit në rastin konkret është realizuar mes dy palëve, ku nga njëra anë në cilësinë e premtuesit/dhënësit të përfitimit të paligjshëm qëndrojnë të pandehurit N. B., S. D. dhe K. Zh. dhe në anën tjetër në cilësinë e marrësit të përfitimit të paligjshëm qëndrojnë të pandehurit A. C. dhe Mimoza Margjeka. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje korruptive ka qenë që e pandehura Mimoza Margjeka, për shkak të funksionit të saj si gjyqtare (anëtare e trupit gjykues), të ndikonte në zbutjen e masës së sigurimit personal që ishte caktuar ndaj shtetasit O. B. (vëllai i të pandehurit N. B.). Rezultoi e provuar se të pandehurit N. B., S. D. dhe K. Zh. e kanë përmbushur pjesën e tyre në këtë marrëveshje korrupsioni nëpërmjet dhënies së përfitimit të parregullt në shumën 6,000 euro për të pandehurën Mimoza Margjeka, duke përfituar edhe zbutjen e masës së sigurimit personal që ishte caktuar ndaj shtetasit O. B. nga ajo e “arrest në burg” në “garanci pasurore”. Gjithashtu për gjykatën, në sajë të provave të administruara gjatë gjykimit rezultoi e provuar se edhe të pandehurit A. C. dhe Mimoza Margjeka e kanë përmbushur pjesën e tyre në këtë marrëveshje korrupsioni nëpërmjet marrjes së shumës prej 6,000 euro me qëllimin e kryerjes së një veprimi që lidhej me detyrën e gjyqtares Mimoza Margjeka si anëtare e trupit gjykues në çështjen penale me objekt zbutjen e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit O. B. Paratë e përfitimit të paligjshëm nga interpretimi i të gjitha provave në përputhje me njëra-tjetrën, si dhe nga vetë deklaratimet e palëve gjatë gjykimit rezulton që të jenë dhënë pas përfundimit të gjyqit ku takimi i të pandehurve Mimoza Margjeka me të pandehurin K. Zh. ka ndodhur rreth orës 18:00, kur ajo ka marrë edhe vajzën e mitur. Fakti që masa e sigurimit personal në ngarkim të shtetasit O. B. është zëvendësuar kundrejt dhënies së një përfitimi të parregullt në shumën 6,000 euro të pandehurës Mimoza Margjeka rezulton i provuar edhe me anën e bisedave telefonike të përgjuara mes të pandehurve me njëri-tjetrin dhe me familjarët e tyre, të cilët për shkak të pamundësisë ekonomike për ta disponuar një shumë të tillë vihen në lëvizje për ta gjetur atë hua tek të afërm të tjerë.

- Gjykata ka çmuar se marrja e provave dhe fiksimi i tyre në aktet procedurale është kryer në respektim të plotë të ligjit procedural penal, nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale. Provat e paraqitura nga organi i akuzës nuk janë të dyshimta, të pakonfirmuara dhe kontradiktore, por ato janë të lidhura dhe në sinkron me njëra-tjetrën. Në rastin konkret, organi i akuzës arriti që me provat e paraqitura dhe të administruara në gjykim të provojë fajësinë e të pandehurve A. C. dhe Mimoza Margjeka.

- Të pandehurit A. C. dhe Mimoza Margjeka kanë vepruar me dashje, pasi kanë parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tyre dhe kanë vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, me qëllim përfitimi pasuror – marrjen e një përfitimi të paligjshëm – shumën 6,000 euro, me qëllim zbutjen e masës së sigurimit personal që ishte caktuar ndaj shtetasit O. B. (vëllai i të pandehurit N. B.).

- Në këto kushte, gjykata krijoi bindjen e brendshme tej çdo dyshimi të arsyeshëm¹ se të pandehurit A. C. dhe Mimoza Margjeka kanë konsumuar elementet e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 319/ç - 25 të Kodit Penal dhe vendosi t’i deklarojë fajtorë për kryerjen e saj.

15. Me këto veprime të konstatuara nga Gjykata e Posaçme, trupi gjykues vlerëson se subjekti Mimoza Margjeka ka shkelur standardet e sjelljes së një gjyqtari në veçanti, të cilat janë dhe duhet të jenë shumë më të larta se ato të shoqërisë në tërësi, duke treguar mungesë integriteti në zbatimin e ligjit, si dhe me sjelljen e saj personale ajo ka ndikuar në të gjithë sistemin gjyqësor, duke qenë se sjellja e një gjyqtari pritet të jetë një sjellje e paqortueshme, pavarësisht të gjitha rrethanave të paraqitura.

16. Në përfundim, duke vlerësuar se sjellja e subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, trupi gjykues vendosi dërgimin e rezultateve të hetimit, referuar gjetjeve të mësipërme.

17. Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e saj për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

18. Në përgjigje të rezultateve të hetimit të dërguara² nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit³ i kërkoi Komisionit pezullimin e procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj saj deri në përfundimin e çështjes penale me një vendim të formës së prerë.

19. Trupi gjykues në mbledhjen e datës 4.5.2023, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, doli në përfundimin se duhet pritur/shtyrë procesi derisa Gjykata e Apelit të marrë vendim në lidhje me çështjen penale në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka. Për këtë vendim të trupit u njoftua edhe subjekti i rivlerësimit.

¹ Neni 4, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale, përcakton se gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

² Me shkresën nr. *** prot., datë 25.4.2023.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.5.2023.

20. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka njoftuar⁴ Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit në lidhje me informacionin e kërkuar më parë për ecurinë e procesit penal ndaj subjektit të rivlerësimit/të së pandehurës në proces penal Mimoza Margjeka. Informacioni i dërguar ka përmbajtje si vijon:

20.1 Në seancën gjyqësore të datës 12.12.2023, ora 10:30, pas relativitetit të palëve në seancë, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vendosi:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 15.12.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.*
- *Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 45 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.*

21. Në datën 16.1.2024, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit ka paraqitur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dokumentin *Gjetje dhe Mendim*, rreth nevojës që Komisioni:

- *Të rifillojë dhe të përfundojë pa vonesa të panevojshme procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka, për shkak të pavarësisë së procesit të rivlerësimit nga procedimet e tjera të zakonshme disiplinore (dhe administrative). Duke bërë këtë, Komisionit i rekomandohet:*
- *Të administrojë si provë dy vendimet e sipërpërmendura në procesin aktual dhe t'i konsiderojë ato në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të procedurës.*

22. Vëzhguesi Ndërkombëtar përsëriti përmbajtjen e gjetjeve dhe mendimit të tij të datës 16.3.2023 sipas të cilit sjellja e subjektit të rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, duke deklaruar:

- *Dy vendimet e lartpërmendura (i fundit i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar i datës 12.12.2023) duhet të konsiderohen brenda kuadrit të vlerësimit të përgjithshëm të procedimit bazuar në standardet e përshtatshme të etikës që rregullojnë funksionin e një gjyqtari.*
- *Pavarësia e institucioneve të rivlerësimit dhe autonomia e institucioneve të rivlerësimit ka qenë thelbësore për sistemin e vënë në zbatim nga neni 179/b i Kushtetutës dhe nga Aneksi i saj. Prandaj, fati i procesit të rivlerësimit për një subjekt rivlerësimi nuk mund t'i nënshtrohet procedimeve të tjera disiplinore (ose administrative) të zakonshme pasi do të pengonte dhe pavleftësonte qëllimin e procesit të rivlerësimit dhe duhet të konsiderohet gjithashtu si antikushtetues.*

23. Në funksion të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me shkresën⁵ me lëndë *Kërkesë për dokumentacion*, i kërkoi Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vënien në dispozicion të kopjes së vendimit të mësipërm, e cila ka përcjellë⁶ aktin “Shkurtim vendimi” nr. ***, datë 12.12.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërsa me shkresën nr. *** prot., datë 13.2.2024,

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.12.2023.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.1.2024.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2024.

kjo gjykatë ka përcjellë aktin “Vendim” nr. ***, datë 12.12.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

24. Sa më sipër, pas njohjes me vendimin e arsyetuar të sipërcituar, Komisioni vendosi ta njoftojë subjektin Mimoza Margjeka me rezultatet e hetimit administrativ nëpërmjet *email-it* zyrtar të datës 29.1.2024 dhe shkresës⁷ nr. *** prot., datë 29.1.2024, së cilës iu kërkua të paraqiste shpjegimet përfundimtare brenda datës 5.2.2024, duke i lënë barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtyre rezultateve të hetimit për procesin e rivlerësimit të saj, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

25. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁸ se: *“Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit me kërkesën e tij drejtuar Gjykatës së Posaçme të Apelit, nëpërmjet së cilës ka kërkuar informacion për ecurinë e procesit penal ndaj subjektit të rivlerësimit të së pandehurës në procesin penal Mimoza Margjeka, ka intimiduar gjykatën dhe ka ndërhyrë dhe ndikuar padrejtësisht në dhënien e një vendimi në disfavorin tim.*

*Nga korrespondenca me shkresën nr. *** prot., datë 12.12.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit në përgjigje të kërkesës së ONM-së ka dhënë informacion po në të njëjtën ditë që është dhënë vendimi, duke cituar datën, ditën dhe orën, si për t’u shfajësuar dhe për të thënë që ne e bëmë atë që duhej. Kjo situatë ka ndikuar në paanësinë dhe pavarësinë e gjykatës dhe ka cenuar procesin e rregullt ligjor. E njëjta situatë ka ndodhur edhe në gjykimin e kësaj çështjeje në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, datë 16.1.2024, të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Gjetje dhe Mendim, ku ka sugjeruar Komisionin të fillojë dhe të përfundojë procesin e rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka.*

ONM-ja citon se fati i procesit të rivlerësimit për një subjekt rivlerësimi nuk mund t’i nënshtrohet procedimeve të tjera disiplinore ose administrative të zakonshme, pasi do të pengonte dhe pavleftësonte qëllimin e procesit të rivlerësimit dhe duhet të konsiderohet gjithashtu si antikushetues.

Sa më sipër rezulton se ONM-ja në shkresën datë 16.1.2024 e ka quajtur si ankikushtetuese nëse subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procedimeve të tjera disiplinore ose administrative të zakonshme, pasi do të pengonte dhe pavleftësonte qëllimin e procesit të rivlerësimit.

*Në lidhje me këtë përcaktim të bërë nga ONM-ja, ju citoj nenin 140, pika 2/b e Kushtetutës, në të cilin është parashikuar se gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Kushtetuta e ka parashikuar rastin kur një gjyqtare është dënuar si rrjedhojë e një procesi penal, në këtë rast organi administrativ që vendos është Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në vazhdim të kësaj ju informoj se nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar data e seancës për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për përfundimin e hetimit disiplinor me iniciativë për veprimtarinë e magjistrates Mimoza Margjeka dhe me vendimin nr. ***, datë 18.1.2024, të ILD-së është vendosur propozimi i masës disiplinore, shkarkim nga detyra, parashikuar nga neni 140, pika 2/b e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.*

⁷ Subjekti është njoftuar nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2024, ku ka nënshkruar marrjen njoftim të kësaj shkrese përcjellëse bashkë me rezultatet e hetimit.

⁸ Shihni përgjigjet e subjektit datë 5.2.2024, në dosjen e Komisionit.

Në datën 19.1.2024 jam vënë në dijeni të akteve të nxjerra⁹ nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Në përfundim të hetimit disiplinor nga ILD-ja është propozuar marrja e masës disiplinore ndaj magjistrates Mimoza Margjeka, shkarkim nga detyra, bazuar në nenin 140, pika 2/b e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 104, pika 3 dhe neni 11, pika 1/b e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në raportin nr. *** prot., datë 18.1.2024, për përfundimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistrates Mimoza Margjeka, në faqen 14 thuhet se për caktimin e masës disiplinore, shkarkim nga detyra, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte:

a. gjyqtari të jetë dënuar për kryerjen e një krimi; b. vendimi i dënimit të jetë i formës së prerë.

Sipas këtij raporti jemi në kushtet e një dënimi me vendim të formës së prerë, pasi vendimi i fajësisë i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit.

Në këto kushte kërkoj nga ana juaj vazhdimin e pezullimit të së procedurës së vlerësimit e, në rast shkarkimi nga KLGJ-ja, do të bëni ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj meje. Sipas nenit 140, pika 2/b e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kompetente në këtë rast është KLGJ-ja.

Ankimi ndaj vendimit të KLGJ-së do të shqyrtohet nga Kolegji i Apelimit sipas nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në të cilin parashikohet se: “3. Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën shqyrton ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Nga ana juaj, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më është kaluar barra e provës për të provuar pafajësinë time për një çështje penale. Në procesin penal, barra e provës i takon prokurorit dhe, në rastin e dënimit me vendim të formës së prerë, është KLGJ-ja ajo që merr vendim për magjistratin sipas nenit 140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kuptimi i vendimit gjyqësor i formës së prerë është përcaktuar në vendimin unifikues nr. 2, datë 3.11.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” nuk parashikon procedurë rivlerësimi për gjyqtarin kur ai ndiqet penalisht dhe dënohet nga gjykata.

Për sa i përket procedurës administrative, referuar ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 1, shkronja “d”, është përcaktuar se objekti i këtij ligji është përcaktimi i statusit të magjistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me: d) përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre. Dhe në këtë rast është organi i qeverisjes së gjyqësorit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili ka kompetencën për të

⁹ Kërkesë nr. *** prot., datë 18.1.2024, për fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjistrates Mimoza Margjeka, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Njoftim nr. *** prot., datë 18.1.2024, Për përfundimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistrates M. M.

Vendim nr. *** prot., datë 18.1.2024, Për përfundimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistrates M. M.

Raporti nr. *** prot., datë 18.1.2024, Për përfundimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistrates M. M.

pezulluar magjistratin në rastin e një çështjeje penale dhe, në rast dënimi me vendim të formës së prerë, KLGJ-ja¹⁰ shkarkon magjistratin nga detyra.

Sa më sipër rezulton se procedura juaj administrative është mbivendosur me një procedurë tjetër administrative të ILD-së dhe KLGJ-së.

Në këto kushte kërkoj nga ana juaj vazhdimin e pezullimit të procedurës së vlerësimit, e cila, në rast shkarkimi nga KLGJ-ja, do të ndërpritet. Bashkëngjitur ju dërgoj aktet e cituara në këtë shkresë që kanë të bëjnë me procedurën e ndjekur nga ILD-ja dhe KLGJ-ja”.

Vlerësimi i Komisionit

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni mori në analizë shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituara¹¹ pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me kërkesën për vazhdimin e pezullimit të procedurës së rivlerësimit për shkak të mbivendosjes së procedurës administrative me një procedurë tjetër administrative të ILD dhe KLGJ. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vlerëson se është Institucion i pavarur dhe autonom në drejtim të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve dhe ky ka qenë parimi thelbësor për këtë sistem, i vënë në zbatim nga neni 179/b i Kushtetutës dhe nga Aneksi i saj.

27. Referuar vendimit nr. 2/2017¹² të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera.

28. Në këtë kuadër, procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka është kryer duke iu referuar parimeve të procesit të rregullt ligjor, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjin nr. 84/2016.

29. Për shkak të dënimit të subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka me vendim të formës së prerë nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 319/ç-25 të Kodit Penal, Komisioni, referuar këtij fakti i administroi si provë këto vendime¹³ dhe i konsideroi ato në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të procedurës së rivlerësimit duke dalë në përfundimin se veprimet dhe sjellja e subjektit të rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

¹⁰ Sipas ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 104 parashikohet rasti i procedimit disiplinor për shkak të kryerjes së një vepre penale.

¹¹ Subjekti ka paraqitur shkresën me lëndë: *Relacion në lidhje me shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2024, të KPK-së dhe rezultatet e hetimit për subjektin Mimoza Margjeka, protokolluar me nr. *** prot., datë 5.2.2024.*

¹² Sipas neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas neni 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera”.

¹³ Vendimi nr.***, datë 15.12.2022, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe vendimi nr.***, datë 12.12.2023, i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

30. Komisioni vendosi të ftojë znj. Mimoza Margjeka në seancë dëgjimore, në datën 26.2.2024, ora 10:00, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, me njoftimin e bërë në adresat elektronike, me *email*, në datën 22.2.2024.

31. Gjithashtu, subjekti u njoftua edhe nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2024, në adresën e saj të banimit, adresë e njëjtë e përdorur edhe për njoftime të mëparshme, ku rezultoi se nuk kishte nënshkruar dokumentin *Lajmërim marrje*.

32. Me dërgimin e njoftimit në adresat elektronike të vëna në dispozicion nga subjekti në kuadrin e procesit të rivlerësimit, si dhe dërgimit të njoftimit postar (adresa të njohura të deklaruar dhe përdorura nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe gjatë procesit administrativ), Komisioni e konsideron të ezauruar procesin e njoftimit. Kjo fazë e procesit lidhur me njoftimin e subjektit të rivlerësimit është ndjekur në përputhje të plotë me pikat 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet edhe se: “*Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë dhe është i detyruar të aksesojë e të përdorë adresën elektronike zyrtare gjatë procesit të rivlerësimit*”.

33. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën e planifikuar dhe shpallur edhe në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kjo seancë u zhvillua në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 26.2.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

34. Në këtë seancë dëgjimore si subjekti i rivlerësimit apo edhe ndonjë përfaqësues i saj nuk morën pjesë. Komisioni konstatoi se subjekti deri në atë moment nuk kishte dërguar asnjë kërkesë paraprake si me anë të postës elektronike, as asaj zyrtare pranë Komisionit.

35. Për sa kohë Komisioni e konsideroi të rregullt procedurën e njoftimit të bërë palës në këtë proces administrativ sipas ligjit nr. 84/2016, si dhe mungesën e ndonjë kërkesë paraprake procedurale deri në atë moment, zhvilloi seancën dëgjimore pa praninë e subjektit të rivlerësimit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, provat e administruara, rekomandimet e vëzhguesit ndërkombëtar, përgjigjet e subjektit, bazuar në vlerësimin tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, konkludon se subjekti i rivlerësimit, e dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, referuar shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 26.2.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi